



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Strategjia e Teknologjisë së Informacionit INSTAT 2025-2031

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Vizioni dhe Misioni	3
3. Statusi Aktual i Infrastrukturës të TI.....	3
4. Objektivat Strategjike	4
5. Lidhja e Objektivave Strategjike të TI me Objektivat Zhvillimore	5
6. Përmirësimet Teknologjike	9
8. Bashkëpunimi me Palët Kombëtare dhe Ndërkombëtare	10
9. Monitorimi dhe Vlerësimi.....	10
10. Analiza SWOT.....	11
11. Zbatimi dhe Shpërndarja e Burimeve	12

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



1. Hyrje

Strategjia e Teknologjisë së Informacionit (TI) për INSTAT përcakton rrugën për përmirësimin e infrastrukturës dixhitale, sigurisë kibernetike dhe aftësive të menaxhimit të të dhënave të INSTAT, për të mbështetur prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare. Kjo strategji trajton sfidat aktuale të infrastrukturës, forcon sigurinë kibernetike dhe mbështet integrimin e teknologjive të avancuara dhe automatizimit për të përmirësuar proceset statistikore dhe sigurinë e të dhënave.

2. Vizioni dhe Misioni

Vizioni: Të krijojë një mjedis modern të TI, të sigurt dhe fleksibël që mbështet misionin e INSTAT për të prodhuar statistika zyrtare me cilësi të lartë.

Misioni: Të fuqizojë INSTAT përmes adoptimit të teknologjive më të avancuara, të thjeshtojë proceset statistikore, të përmirësojë sigurinë e të dhënave dhe të nxisë inovacionin në mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave.

3. Statusi Aktual i Infrastrukturës të TI

Infrastruktura aktuale e TI të INSTAT reflekton një transformim të rëndësishëm pas një sërë ndërhyrjesh që kanë adresuar sfidat në lidhje me sigurinë, performancën dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve. Aktualisht, **rrjeti i institucionit** është segmentuar dhe organizuar në VLAN, duke rritur sigurinë dhe izolimin ndërmjet segmenteve të ndryshme. **Politikat e sigurisë** në firewall janë përditësuar dhe forcuar për të përballuar më mirë kërcënimet kibernetike.

Serverat, fizikë dhe virtualë, janë pajisur me sisteme operative të përditësuara për të siguruar performancë dhe stabilitet maksimal. **Bazat e të dhënave** janë në versionin më të fundit të SQL Server, duke përfshirë konfigurim të avancuar për optimizim të performancës dhe sigurisë. Serverat janë lidhur me një domain Active Directory, ndërsa serveri për shërbime online është vendosur në DMZ për të ofruar nivel më të lartë mbrojtjeje.

Sistemi i postës elektronike është zhvendosur në platformën Exchange Online, e lidhur me domain-in institucional për funksionim të sigurt dhe të qëndrueshëm. Për mbrojtjen e përdoruesve fundorë dhe Serverave, përdoret Microsoft Defender, ndërsa një autentifikim shumë-faktor përmes platformës DUO MFA është integruar për të garantuar qasje të sigurt.

Është ngritur një **sistem i avancuar backup-i dhe replikimi**, duke përfshirë një site sekondar për mbrojtje dhe rikuperim emergjent të të dhënave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Megjithë këto përmirësime, sulmet kibernetike dhe nevojat në rritje, kanë evidentuar fusha ku infrastruktura duhet të vazhdojë të përmirësohet, duke përfshirë sigurinë, integrimin dhe efikasitetin e përgjithshëm.

Përdorimi i gjuhës R në proceset statistikore ka pasur zhvillim, megjithatë, përhapja dhe intensiteti i aplikimit të saj mbetet i pabarabartë midis sektorëve. Kjo situatë nënvizon nevojën për një qasje të harmonizuar për **ngritjen e kapaciteteve**, me synim përforcimin dhe standardizimin e përdorimit të R në të gjitha fazat e prodhimit statistikor.

INSTAT disponon një infrastrukturë funksionale të sistemeve të brendshme që mbështesin ciklin e prodhimit statistikor si edhe planifikimin e punës. Këto sisteme janë të ndërlidhura dhe përfshijnë aplikacione për planifikimin dhe monitorimin e aktiviteteve statistikore në përputhje me GSBPM, menaxhimin e metadatave dhe cilësisë së të dhënave, si dhe mbledhjen dhe përpunimin e informacionit nga vrojtimet statistikore dhe burimet administrative.

Gjithashtu, për përdoruesit e jashtëm, INSTAT ka zhvilluar platforma për publikimin e të dhënave statistikore, përfshirë databazën statistikore, si dhe shërbime të bazuara në elementet gjeohapësinorë përmes WebGIS.

Pavarësisht përparimeve, nevojat për integrim më të mirë ndërmjet sistemeve, zhvillimin e kapaciteteve analitike dhe modernizimin e platformave ekzistuese mbeten prioritet të vazhdueshme në funksion të rritjes së efikasitetit dhe sigurimit të cilësisë së shërbimeve statistikore.

4. Objektivat Strategjike

1. Forcimi i Kuadrit të Sigurisë Kibernetike

- Zbatimi i mjeteve të përmirësuara të sigurisë, firewall-ve dhe sistemeve të back up për mbrojtjen e të dhënave.
- Përmirësimi i kapaciteteve teknike në lidhje me sigurinë kibernetike për të monitoruar kërcënimet dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë proaktive.

2. Përmirësimi i Infrastrukturës TI

- Përmirësimi i serverave në INSTAT për të trajtuar volume më të mëdha të dhënash dhe për të kryer proceset statistikore në mënyrë efikase.
- Përmirësimi i sistemeve të brendshme për integrimin dhe automatizimin e të dhënave, duke përfshirë ato që trajtojnë të dhënat administrative.
- Përmirësimi i pajisjeve fundore

3. Mbështetja e Inovacionit në Proceset Statistikore

- Integrimi i mësimit të makinerive (Machine learning - ML) për analizën parashikuese për të prodhuar rezultate statistikore më të avancuara dhe për të thjeshtuar përpunimin e të dhënave. ML gjithashtu mund të përdoret për të përmirësuar metodologjitë e anketave, duke reduktuar ngarkesën e të përgjigjurve dhe duke rritur efikasitetin e proceseve të mbledhjes së të dhënave.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Zgjerimi i përdorimit të teknologjive moderne dhe përmirësimi i automatizimit në volumet e të dhënave.
- Promovimi i përdorimit të R për analizë të avancuar të të dhënave dhe për llogaritjen e treguesve të cilësisë.

4. Ndërtimi i Kapaciteteve dhe Trajnimi

- Trajnime të rregullta mbi sigurinë kibernetike, menaxhimin TI dhe analizën e të dhënave për të siguruar që punonjësit të jenë të pajisur me njohuritë e nevojshme për të përballuar sfidat dhe menaxhuar sistemet moderne.

Trajnime specifike mbi përdorimin e inteligjencës artificiale dhe teknologjive të machine learning, me qëllim rritjen e kapaciteteve për zbatimin e metodave të avancuara në proceset statistikore.

5. Forcimi i Kuadrit të Qeverisjes së të Dhënave

- Përcaktimi i objektivit për krijimin e një kuadri të plotë të qeverisjes së të dhënave për të siguruar cilësi të lartë të të dhënave, privatësi dhe pajtueshmëri me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

5. Lidhja e Objektivave Strategjike të TI me Objektivat Zhvillimore

Tabela më poshtë paraqet objektivat zhvillimore të INSTAT dhe objektivat strategjike përkatës të TI, duke demonstruar se si përparimet në TI do të kontribuojnë në arritjen e qëllimeve më të gjera institucionale. Duke përafruar iniciativat e TI me prioritetet e zhvillimit, INSTAT siguron që përmirësimet teknologjike mbështesin drejtpërdrejt misionin e përgjithshëm të INSTAT, duke u fokusuar në efikasitetin, sigurinë dhe inovacionin në prodhimin statistikor.

Objektivat Zhvillimore të INSTAT	Objektivat Strategjike të TI
Objekti 1: Zhvillimi i INSTAT për të përafruar aktet ligjore sipas acquis communautaire lidhur me statistikat	- Forcimi i Kuadrit të Sigurisë Kibernetike: Sigurimi i pajtueshmërisë me standard evropiane përmes masave dhe mjeteve të përmirësuara të sigurisë kibernetike.
	- Përmirësimi i Infrastrukturës TI: Përmirësimi i serverave dhe sistemeve për të përmbushur nevojat për harmonizimin e akteve ligjore me kërkesat e acquis.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

	- Forcimi i Kuadrit të Qeverisjes së të Dhënave: Forcimi i kuadrit të qeverisjes së të dhënave ndihmon për të siguruar që INSTAT të jetë në përputhje me standardet ligjore evropiane, veçanërisht për sa i përket privatësisë së të dhënave (p.sh., mbrojtjen e të dhënave personale), cilësisë së të dhënave dhe transparencës, të cilat janë thelbësore për harmonizimin me <i>acquis communautaire</i>.
Objektivi 2: Plotësimi i kërkesave të përdoruesve për statistika zyrtare	- Përmirësimi i Infrastrukturës TI: Përmirësimi i sistemeve të brendshme për integrimin dhe automatizimin e të dhënave për të përmbushur më mirë kërkesat e përdoruesve për rezultate statistikore të sakta dhe në kohë.
	- Mbështetja e Inovacionit në Proceset Statistikore: Përdorimi i teknologjive të avancuara për prodhimin statistikor për të përmbushur nevojat e përdoruesve në vend dhe ata ndërkombëtarë, për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e përpunimit të të dhënave. Lehtësimi i aksesimit në kuadër të kërkimit shkencor
Objektivi 3: Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuar Evropiane dhe ndërkombëtare.	- Përmirësimi i Infrastrukturës TI: Modernizimi i sistemeve të trajtimit të të dhënave për të përmbushur standardet ndërkombëtare të cilësisë.
	- Forcimi i Kuadrit të Qeverisjes së të Dhënave: Një kuadër i fuqishëm i qeverisjes së të dhënave siguron cilësi të lartë të të dhënave, metoda të qëndrueshme dhe pajtueshmëri me standardet statistikore ndërkombëtare. Kjo është thelbësore për prodhimin e statistikave të besueshme dhe të sakta që përmbushin pritshmëritë evropiane dhe ndërkombëtare.
	- Ndërtimi i Kapaciteteve dhe Trajnimi: Zhvillimi i kapaciteteve, në bashkëpunim me partnerët, për të rritur profesionalizmin dhe për

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Objektivi 4: Rritja e bashkëpunimit të INSTAT-it me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare	të mundësuar një bashkëpunim efektiv ndërkombëtar.
	- Forcimi i Kuadrit të Sigurisë Kibernetike: Sigurimi i komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare përmes protokolleve të fuqishme të sigurisë kibernetike.
Objektivi 5: Modernizimi i proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efikasitetin në kosto të statistikave zyrtare	- Mbështetja e Inovacionit në Proceset Statistike: Modernizimi i mbledhjes, përpunimit, transmetimit dhe shpërndarjes së të dhënave përmes automatizimit dhe mjeteve të avancuara të analizës së të dhënave, si R dhe algoritmet e mësimin të makinerive.
	- Përmirësimi i Infrastrukturës TI: Përmirësimi i aplikacioneve për mbledhjen e të dhënave (CATI/CAWI/CAPI) për të rritur efektivitetin dhe modernizuar procesin e mbledhjes së të dhënave.
Objektivi 6: Të arrihet besimi i lartë në publik i INSTAT dhe rritja e vazhdueshme e përdoruesve të statistikave zyrtare.	- Ndërtimi i Kapaciteteve dhe Trajnimi: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve statistikore dhe rritja e besimit duke trajnuar punonjësit mbi mjetet dhe metodat e reja TI.
	- Përmirësimi i Infrastrukturës TI: Sigurimi i qasjes së besueshme në statistikat zyrtare përmes sistemeve dhe platformave të përmirësuara të shpërndarjes së të dhënave.

Objektivi 1: Zhvillimi i INSTAT për të përafruar aktet ligjore sipas acquis communautaire lidhur me statistikat

Arritja e harmonizimit me standardet evropiane kërkon jo vetëm përditësime ligjore, por edhe një bazë të fortë dhe të sigurt TI. Kjo reflektohet te objektivat për Forcimin e Kuadrit të Sigurisë Kibernetike dhe Përmirësimin e Infrastrukturës TI, të cilat synojnë mbrojtjen e integritetit të të dhënave dhe sigurimin që infrastruktura është e aftë të përballojë kërkesat në rritje për pajtueshmëri me acquis-in. Mjetet e përmirësuara të sigurisë kibernetike, punonjës të dedikuar

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

dhe infrastruktura TI formojnë bazën e këtij harmonizimi, duke siguruar pajtueshmëri me kërkesat ligjore kombëtare dhe evropiane.

Objektivi 2: Plotësimi i kërkesave të përdoruesve për statistika zyrtare

Ndërsa kërkesat e përdoruesve për statistika të sakta, të aksesueshme dhe të kohës rriten, bëhet thelbësore nevoja për integrimin më efikas të të dhënave dhe proceset e automatizuara. Objektivi për Përmirësimin e Infrastrukturës TI fokusohet në përmirësimin e sistemeve të brendshme për të përmbushur këto kërkesa. Gjithashtu, objektivi për Mbështetjen e Inovacionit në Proceset Statistikore thekson zgjerimin e përdorimit të teknologjive të avancuara për të prodhuar rezultate me cilësi të lartë, të orientuara nga përdoruesit, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Këto përpjekje do të ndihmojnë INSTAT të përmbushë nevojat e palëve të interesuara duke përmirësuar saktësinë, qasjen dhe shpejtësinë e shpërndarjes së të dhënave.

Objektivi 3: Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranura Evropiane dhe ndërkombëtare

Statistikat me cilësi të lartë varen nga sistemet dhe proceset efektive të menaxhimit të të dhënave. Objektivi për Mbështetjen e Inovacionit në Proceset Statistikore promovon adoptimin e teknikave të avancuara për të përmirësuar saktësinë dhe efikasitetin e përpunimit të të dhënave. Për më tepër, objektivi për Përmirësimin e Infrastrukturës TI siguron që sistemet teknike që përdoren për të përpunuar, ruajtur dhe publikuar të dhënat janë në përputhje me standardet e rrepta të cilësisë, të kërkuara si në nivel evropian ashtu edhe ndërkombëtar.

Objektivi 4: Rritja e bashkëpunimit të INSTAT-it me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare

Bashkëpunimi me institucionet e jashtme kërkon sisteme të sigurta dhe të besueshme për shkëmbimin dhe komunikimin e të dhënave. Objektivi për Ndërtimin e Kapaciteteve dhe Trajnimin mbështet këtë bashkëpunim, duke siguruar që punonjësit e INSTAT të kenë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të punuar në mënyrë efektive me partnerët. Për më tepër, objektivi për Forcimin e Kuadrit të Sigurisë Kibernetike garanton sigurinë e këtyre bashkëpunimeve duke mbrojtur të dhënat e ndara me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, gjë që është thelbësore për ruajtjen e besimit dhe sigurimin e integritetit të statistikave zyrtare.

Objektivi 5: Modernizimi i proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efikasitetin në kosto të statistikave zyrtare.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Modernizimi i proceseve të INSTAT është thelbësor për përmirësimin e efikasitetit, cilësisë së të dhënave dhe ofrimin e shërbimeve. Objektivi për Mbështetjen e Inovacionit në Proceset Statistike promovon automatizimin dhe përdorimin e mjeteve të avancuara të analizës, si R për analizën statistikore dhe llogaritjen e treguesve të cilësisë. Objektivi për Përmirësimin e Infrastrukturës TI mbështet më tej këtë modernizim duke siguruar që sistemet që përdoren për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, si aplikacionet CATI/CAWI/CAPI, të jenë të përditësuara dhe të afta për të përballuar metodat e reja të mbledhjes dhe analizës së të dhënave. Këto përpjekje do të lehtësojnë flukset e punës dhe do të përmirësojnë cilësinë e përgjithshme të rezultateve statistikore.

Objektivi 6: Të arrihet besimi i lartë në publik i INSTAT dhe rritja e vazhdueshme e përdoruesve të statistikave zyrtare.

Besimi i publikut të INSTAT varet si nga cilësia e statistikave të prodhuara, ashtu edhe nga transparencja. Objektivi për Ndërtimin e Kapaciteteve dhe Trajnimin trajton këto elemente duke siguruar që punonjësit të jenë të përgatitur mirë për të menaxhuar dhe përdorur mjetet TI në mënyrë efektive, gjë që përmirëson saktësinë dhe besueshmërinë e rezultateve statistikore. Përveç kësaj, Përmirësimi i Infrastrukturës TI siguron që statistikave zyrtare të jenë lehtësisht të aksesueshme për publikun përmes platformave të besueshme të shpërndarjes së të dhënave, duke kontribuar në kënaqësinë më të madhe të përdoruesve dhe në rritjen e besimit ndaj shërbimeve të INSTAT.

6. Përmirësimet Teknologjike

Përmirësimet e planifikuara do të adresojnë disa fusha kritike:

- **Përmirësimi i Serverave:** Serverat e INSTAT do të modernizohen për të siguruar përpunim efikas të të dhënave dhe kapacitet më të madh ruajtjeje.
- **Modernizimi i Sistemeve:** Sistemet e brendshme do të përditësohen për të siguruar integritet me burimet e të dhënave administrative kombëtare, duke përmirësuar cilësinë dhe kohën e prodhimit të statistikave zyrtare.
- **Automatizimi:** Rritja e automatizimit do të përmirësojë saktësinë, do të reduktojë punën manuale dhe do të rrisë efikasitetin e përpunimit.
- **Politika e Cilësisë së Të Dhënave:** Do të prezantohen standarde dhe mjete për të monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e të dhënave përmes dataset-eve.
- **Privatësia dhe Konfidencialiteti i Të Dhënave:** Do të sigurohet pajtueshmëria me konfidencialitetin statistikor, mbrojtjen e të dhënave personale dhe metodat e Kontrollit të Zbulimit Statistik.
- **Menaxhimi i Metadatave:** Do të standardizohen metadatat duke përdorur SDMX, duke siguruar që të gjitha datasetet të jenë mirë-dokumentuara.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- **Politika e Ruajtjes së të Dhënave:** Do të përcaktohen rregulla se sa gjatë duhet të ruhen të dhënat dhe si duhet të shkatërohen në mënyrë të sigurt.

7. Siguria Kibernetike dhe Menaxhimi i Rrezikut

Ndërtimi i një kuadri të fortë të sigurisë kibernetike është thelbësor. Auditimet e rregullta të sigurisë do të sigurojnë që dobësitë të identifikohen dhe adresohen me shpejtësi. Një plan i përgjithshëm për reagimin ndaj incidenteve do të zbatohet, së bashku me teste të rregullta për rikuperimin nga katastrofat për të ruajtur vazhdimësinë e biznesit.

8. Bashkëpunimi me Palët Kombëtare dhe Ndërkombëtare

Bashkëpunimi me institucionet kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare do të vazhdojë për të forcuar pozitat e INSTAT. Shkëmbimi i të dhënave dhe metodologjive me partnerët kombëtarë do të përmirësojë integrimin e të dhënave administrative, ndërsa partneritetet me institucione ndërkombëtare do të ndihmojnë INSTAT të adoptojë praktikën më të mira në TI lidhur me statistikat zyrtare. Për më tepër, do të krijohen protokolle të qarta për ndarjen e të dhënave për të siguruar shkëmbim të dhënash të sigurt, të përputhshëm dhe efikas me të gjitha palët e interesuara.

9. Monitorimi dhe Vlerësimi

Treguesit kryesorë të performancës (TKP) janë përcaktuar për të matur suksesin e strategjisë, duke u përqendruar në kohën e punës së sistemeve, reduktimin e incidenteve të sigurisë kibernetike, pjesëmarrjen në trajnime të punonjësve dhe përmirësimet e përgjithshme në TI.

Objektivi Strategjik	Treguesit kryesorë të performancës (TKP)
1. Forcimi i Kuadrit të Sigurisë Kibernetike	- % reduktimi i incidenteve të sigurisë kibernetike për vit
	- Numri i auditimeve të sigurisë të suksesshme të kryera
	- Koha e reagimit ndaj incidenteve (koha mesatare për të zgjidhur incidentet e sigurisë kibernetike)
	- Zbatimi i testeve për rikuperimin nga katastrofat (numri i testeve të kryera)
	- % e sistemeve me pajisje të sigurta dhe firewalle të përditësuara
2. Përmirësimi i Infrastrukturës TI	- Numri i përmirësimeve(upgrade) të kryera të serverave
	- % e kohës së punës për sistemet kritike të TI
	- % e proceseve statistikore të automatizuara

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

3. Mbështetje për Inovacionin në Proceset Statistike	- Numri i teknologjive të reja të implementuara
4. Ndërtimi i Kapaciteteve dhe Trajnimi	- Numri i punonjësve të TI të trajnuar çdo vit
	- % e punonjësve që raportojnë përmirësim të aftësive në menaxhimin e TI, sigurinë kibernetike dhe analizat e të dhënave
	- Numri i seancave të trajnimit të kryera (siguria kibernetike, analiza e të dhënave, sistemet e TI, etj)
	- Trajnimi në praktikat më të mira të menaxhimit të të dhënave, protokollat e sigurisë.
	- Trajnimi në mësimin e makinerive për të përmirësuar kapacitetin e punonjësve të INSTAT për të zbatuar modele ML në proceset statistikore.

10. Analiza SWOT

- Pika të Forta**

- **Infrastruktura TI e krijuar:** INSTAT ka një themel të fortë, me sisteme që mbështesin menaxhimin e të dhënave dhe ruajtjen e metadatave.
- **Punonjës të kualifikuar:** Eksperienca në menaxhimin e dataseteve dhe sigurimin e statistikore.
- **Potenciali për automatizim:** Përpjekjet e vazhdueshme për automatizim tregojnë gatishmërinë për të pranuar inovacione që reduktojnë procesimin manual.

- Dobësi**

- **Përgjigjet ndaj sigurisë kibernetike:** Sulmi kibernetik i janarit 2024 zbuloi dobësi në aftësinë e INSTAT për të parandaluar kërcënimet e sigurisë.
- **Sistemet e vjetruara:** Disa procese të INSTAT-it mbeten manuale dhe joefikase, duke e bërë më të vështirë përmbushjen e kërkesave moderne për të dhëna.
- **Sfidat e integritetit të të dhënave:** Menaxhimi i të dhënave administrative nga institucionet në vend është i vështirë për shkak të formateve të ndryshme dhe identifikuesve të të dhënave.

- Mundësi**

- **Pranimi i teknologjive të reja:** Mjetet e avancuara ofrojnë mundësinë për të përmirësuar më tej proceset statistikore.
- **Ndërtimi i kapaciteteve:** Investimi në trajnim të rregullt për punonjësit e TI në fushat e sigurisë kibernetike, analizës dhe menaxhimit të sistemeve do të rrisë

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme.

- **Bashkëpunimi ndërkombëtar:** Bashkëpunimi me institucione si Eurostat e ndihmojnë INSTAT të adoptojë praktikat më të mira ndërkombëtare.

- **Kërcënime**

- **Rreziqet e sigurisë kibernetike:** Sofistikimi në rritje i kërcënimeve kibernetike paraqet një rrezik të vazhdueshëm për sigurinë e të dhënave dhe vazhdimësinë operative të INSTAT.

- **Kufizimet buxhetore:** Kufizimet financiare mund të ngadalësojnë zbatimin e disa projekteve TI, si përmirësimet e sistemeve dhe rekrutimi i punonjësve të rinj.

- **Rezistenca ndaj ndryshimeve:** Rezistenca e brendshme ndaj teknologjive dhe sistemeve të reja mund të pengojë mbarëvajtjen e përmirësimeve të nevojshme.

11. Zbatimi dhe Shpërndarja e Burimeve

Strategjia do të zbatohet në faza, duke u përqendruar fillimisht në përmirësimin e sigurisë kibernetike dhe përmirësimet në infrastrukturë. Buxhetet dhe afatet e detajuara do të zhvillohen për secilin projekt, me një theks të veçantë në adresimin e dobësive kritike dhe shfrytëzimin e mundësive teknologjike.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300

www.instat.gov.al/info@instat.gov.al